

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE I VITIT  
2024**

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundi mit të kërkesës	Tarifa
01	04.01.2024	<p>E deleguar nga Kryeministria</p> <p>- Cili është komenti i qeverisë shqiptare për anulimin e vizitës në Shqipëri nga ana e Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Izraelit z. Eli Cohen, vizitë kjo e planifikuar të zhvillohej nga datat 5/6/7 Nëntor 2023?</p> <p>- A lidhet anulimi i kësaj vizite të Ministrit të Punëve të Jashtme të Republikës së Izraelit z. Eli Cohen, me faktin që qeveria shqiptare ka shkarkuar nga detyra si Konsull Nderi e Shqipërisë në Izrael znj. Nicole Raidman?</p>	10.01.2024	<p>Në përgjigje Tuajës ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>1. Ministri i Jashtëm Izraelit anuloi turin në rajon për shkak të situatës së Izraelit, pas sulmit të Hamasit në fillim të Tetorit.</p> <p>2. Në vijim të përgjigjes për kërkesën tuaj, nëpërmjet e-mail të datës 15.12.2023 se personi në fjalë nuk i mori kurrë funksionet si konsull nderi i Republikës së Shqipërisë. Znj. Raidman mbeti në statusin "kandidaturë", dhe procedura e emërimit nuk u finalizua. Duke mos patur kurrë "emërim", nuk mund të kishte "lirim" nga kjo detyrë, dhe as "shkarkim" (term të cilin ju referoni). Si person privat dhe pa asnjë ofiq zyrtar, çdo korrespondencë e lidhur me kandidaturën e zj. Radman i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	E plotë	Pa tarifë
02	05.01.2024	<p>Në vijim të deklaratës publike për miratimin e Strategjisë së re të Sigurisë Kombëtare 2023-2028 nga Këshilli i Ministrave në dhjetor 2023, lutemi të na vini në dispozicion:</p> <p>1. "Strategjinë e</p>	12.11.2024	Vënë në dispozicion përgjigjia kërkueses	E plotë	Pa tarifë

		<p>Sigurisë Kombëtare 2023-2028”</p> <p>2. Raportin e konsultimit publik për Strategjinë e Sigurisë Kombëtare 2023-2028, duke identifikuar qartë aktorët që janë konsultuar, komentet që janë dhënë, pranuar/refuzuar dhe arsyetimi përkatës.</p>				
03	09.01.2024	<p>Kërkesë nga z. Q.Q: Nga institucioni i Presidencës jam informuar zyrtarisht se Presidenti i Republikës, ka kthyer kandidaturën time për Ambasador në Hungari, për rivlerësim në MEPJ.</p> <p>Në mbështetje të nenit 3, të ligjit 119/2014 " Për të drejtën e informimit", kërkoj nga ana juaj të më vini në dispozicion shkresën e Presidencës për sa më lart.</p>	12.01.2024	Në përgjigje të kërkesës Tuaj datë 09.01.2024 ju bëjmë me dije se bashkëlidhur gjendet administruar dokumenti i kërkuar.	E plotë	Pa tarifë
04	17.01.2024	<p>Kërkesë për informacion:</p> <p>1. Sa është numri i akteve ligjore që keni konsultuar me organizatat jofitimprurëse gjatë vitit 2023?</p> <p>2. Kush kanë qenë format e konsultimit që keni përdorur?</p> <p>3. Sa është numri i OJF-ve që kanë marrë pjesë në këto konsultime?</p> <p>4. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.</p> <p>5. A ka institucioni juaj koordinator për</p>	23.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Për pyetjet 1-3 , MEPJ nuk ka pasur akte që t'i jenë nënshtruar konsultimit publik për vitin 2023, pasi nuk kanë qenë objekt i ligjit nr. 146/2014, për arsye që kanë të bëjnë marrëveshjet ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.</p> <p>Përgjigjia për pyetjen 4: MEPJ ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, me të dhëna kontakti: <a href="mailto:konsultimipublik@mfa.gov.al">konsultimipublik@mfa.gov.al</a>.</p>	E plotë	Pa tarifë

		<p>shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.</p> <p>6. A ka organe këshillimore që funksionojnë pranë institucionit tuaj? Nëse po, ju lutem listojini ato.</p> <p>7. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse po, sa është numri i OJF-ve të përfshirë në to?</p> <p>8. Gjatë 2023, a ka pasur institucioni juaj grupe të përbashkëta pune me pjesëmarrjen e OJF-ve? Nëse po, ju lutem përmendni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëllimin e grupeve;</li> <li>• Numrin e OJF-ve pjesëmarrëse;</li> <li>• Mënyra e përzgjedhjes së OJF-ve.</li> </ul> <p>9. A është trajnuar stafi i institucionit tuaj mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve? Nëse po, sa punonjës janë trajnuar dhe nga kush?</p> <p>10. A ofron institucioni juaj licensa për shërbime të caktuara që ofrohen nga OJF-të? Nëse po, ju lutem specifikoni llojin/et e shërbimit? Sa është numri i OJF-ve të licensuara sipas llojit/llojeve të shërbimit?</p>				
05	24.01.2024	Me urdhër të regjisorit Leka Bungo, përsa i përket premierës absolute të teatrit Kombëtar, "Testamenti" me datë	30.01.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëj me dije si vijon: Për sa keni kërkuar nevojiten dy bileta për Presidentin dhe Zonjën e Parë, dhe pesë për stafin.	E plotë	Pa tarifë

		31.01.2024, ora 19:00 pranë sallës Central 400 në Arturbina, dhe në bazë të protokollit , ju lutem më përcaktoni numrin e vendeve që dëshironi t'ju akordohen si ftesë për Presidentin e Shqipërisë si dhe për stafin e tij.				
06	24.01.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me këto pyetje: 1. Sa shqiptarë janë aktualisht në Gaza? 2. Sa shqiptarë janë evakuuar nga Gaza prej nisjes së luftës në muajin tetor 2023? 3. A keni të dhëna, a ka Shqiptarë që kanë humbur jetën në Gaza prej nisjes së konfliktit në tetor të vitit 2023? Nëse po, sa është numri i tyre?	01.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije si vijon: 1. Aktualisht në Rripin e Gazës janë tre shtetas shqiptarë, të cilët pavarësisht thirrjeve për evakuim (nga Përfaqësite e RSH-së, e ngarkuara me këtë operacion), vendosën të qëndrojnë për shkak të familjaqëve të tyre që nuk janë shtetas shqiptarë. 2. Që prej fillimit të luftës në tetor 2023, janë evakuuar gjithësej 15 shtetas shqiptarë, tre familje. 3. Sipas informacioneve operative (zyrtarisht të pakonfirmuar nga autoritetet vendase) gjatë muajit nëntor 2023, ka humbur jetën një shtetas shqiptar (nënë shqiptare, baba palestinez).	E plotë	Pa tarifë
07	30.01.2024	Kërkesë e deleguar nga Kryeministria Informacion në lidhje me Protokollet e nënshkruara më 22.01.2024.	09.02.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj: Protokollet e nënshkruara më 22.01.2024, në kushtet kur nevojitet që palët të përfundojnë procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e tyre në fuqi, nuk mund t'i vëmë në dispozicion pa përfunduar këto procedura, kjo për të	E plotë	Pa tarifë

				siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërqeveritare/ndërshtetërore me palët nënshkruese. Protokollet mund t'i vëmë në dispozicion pasi të përfundojnë procedurat e brendshme ligjore për hyrjen e tyre në fuqi.		
08	06.02.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me vizitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ligës Botërore Myslimane Dr. Mohamed Abdelkarim Al-Issa, në datat 15-19 shkurt, në Tiranë. Takimin e përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve fetare do ta organizojë Komiteti Shtetëror për Kultet?	06.02.2024	Në lidhje me interesimin tuaj, MEPJ e ka përcjelle për kompetencën tuaj kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ligës Botërore Myslimane(Muslim World League-MWL) Dr. Mohamed Abdelkarim Al-Issa. Vizita ishte planifikuar në përgjigje të ftesës dërguar nga Kryeministri Rama me dt. 17.12.2019. Për arsye të Covid-19, Dr. Al Issa nuk ka mundur të realizojë me parë vizitën. MEPJ e konsideron pozitivisht vizitën në vendin tonë të Sekretarit të Përgjithshëm të Ligës Botërore Myslimane, Dr.Mohammed Abdelkarim Al-Issa, i cili është një personalitet i njohur në mbarë botën. Kjo vizite mund të kontribuonte në: promovimin e vlerave të harmonisë, mirëkuptimit dhe tolerancës nderfetare në vendin tonë; mbështetjen e projekteve të ndryshme humanitare në fusha të tilla, si: shëndetësi, arsim, por edhe në promovimin e turizmit dhe investimeve të huaja, etj; Gjatë vizitës në Tiranë, Dr. Al Issa ka shprehur dëshirën për t'u takuar me Kryeministrin Rama, Presidentin e Republikës	E plotë	Pa tarifë

				Begaj dhe Kryetaren e Parlamentit Nikolla. Gjithashtu, ai planifikon të zhvillojë edhe një takim me përfaqësues të të gjitha komuniteteve fetare në Shqipëri		
09	21.02.2024	Kërkesë për vënien në dispozicion të dokumentave zyrtare “Relacion Shpjegues” të VKM-ve të miratuara nga Këshilli i Mionistrave me Propozim të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.	04.03.2024	Vënë në dispozicion përgjigja kërkuases.	E plotë	Pa tarifë
10	23.02.2024	Përmes kësaj letre ju drejtohem me kërkesën e mundësisë së një takimi të përbashkët me përfaqësuesit e Arkivit të Shqipërisë në Kuadër të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në lidhje me konsultim dhe furnizim me material për temën time të Doktoratës, me titull: 'Pajtimi i Gjaqeve në Kosovë 1990-1992  Materialin të cilin duhet ta konsultoj në këtë rast nga Arkivi juaj ka të bëjë me dokumentet e arkivuara të Ambasadës së Shqipërisë në Beograd, në Turqi, Bon dhe në Wien. Kjo temë lidhet me periudhën e demonstratave dhe ngjarjeve të viteve 68, 81 dhe 89 dhe informata rreth ish të burgosurve politik të asaj kohe në Kosovë.	21.03.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije si vijon: Duhet të paraqiteni fizikisht pranë Arkivit Historik të MEPJ, nga e hëna në të mërkurë, nga ora 10:00 – 14:00, në këtë mënyrë do të mund të mund të konsultoheni dhe me personin që bën shërbimin në Arkivin Historik. Gjithashtu për lehtësi studimi mund t’ju sugjerojmë konsultimin paraprak në versionin online me dokumentacionin e Arkivit Historik, për t’ju njohur me titujt e dosjeve dhe për të përzgjedhur paraprakisht dosjet të cilat mund të përbëjnë interes për temën e studimit tuaj.	E plotë	Pa tarifë
11	26.02.2024	Informacioni i kërkuar është në kuadër të një hulumtimi ligjor (personal), mbi zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në	27.02.2024	Kërkesë deleguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë	E plotë	Pa tarifë

fushën digjitale në shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Në bazë të parashikimeve të PKIE 2023-2025 mbi Aktin e Tregut Digjital dhe Aktin e Shërbimeve Digjitale të Bashkimit Evropian, (seksioni "Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian") dhe rekomandimeve të Progres Raportit të Komisionit Evropian të vitit 2023 për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me Aktin e Tregut Digjital dhe Aktin e Shërbimeve Digjitale të Bashkimit Evropian, ju lutem vini në dispozicion informacionin e mëposhtëm:

- Aktet ligjore, nënligjore, rregullatorë në proces miratimi/të miratuara të cilat bazohen në Aktin e Tregut Digjital dhe Aktin e Shërbimeve Digjitale të Bashkimit Evropian, qëllimi i tyre, koha e planifikuar e konsultimit publik dhe hyrjes në fuqi. (nëse nuk ka të tilla, përcaktohet ky informacion).
- Aktet ligjore, nënligjore, rregullatore të planifikuara ose në proces hartimi të cilat bazohen në Aktin e Tregut Digjital dhe Aktin e Shërbimeve Digjitale të Bashkimit Evropian, qëllimi i tyre, koha e planifikuar e konsultimit publik dhe hyrjes në fuqi. (nëse nuk

ka te tilla, përcaktohet ky informacion).

- A ka pasur ndonjë trajnim, konsultim apo iniciative tjetër informacioni juaj, ne lidhje me Aktin për Shërbimet Digjitale dhe Aktit e Tregut Digjital të Bashkimit Evropian? (duke përfshirë komunikime me institucionet e BE-së, konsultime me institucione te qeverisjes qendrore, trajnime me stafin, konsultime me eksperte etj.) Nëse po, ju lutem përshkruani procesin, kush e organizoi, kush mori pjesë dhe cili ishte qëllimi i aktivitetit.

- A ka kryer institucioni juaj ndonjë analizë/studim/vlerësim në lidhje me zbatimin e Aktit për Shërbimet Digjitale dhe Aktit e Tregut Digjital të Bashkimit Evropian në Shqipëri? Nëse po, cili institucion e ka iniciuar dhe është përgjegjës në këtë drejtim? Sipas analizës, për cilët institucione rekomandohet përfshirja në këtë fushë? Cili institucion rekomandohet të jete Koordinator i Shërbimeve Digjitale?

- Nëse jo, a jeni ne dijeni në rrugë zyrtare të kryerjes së ndonjë analize/kërkimi/studimi nga institucione publike/qeveria shqiptare në lidhje me zbatimin e Aktit për Shërbimet Digjitale dhe



		<p>Aktit e Tregut Digjital të Bashkimit Evropian në Shqipëri? Nëse po, cili institucion e ka iniciuar dhe është angazhuar në këtë drejtim? Sipas analizës, për cilët institucione rekomandohet përfshirja? Cili institucion rekomandohet të jetë Koordinator i Shërbimeve Digjitale?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• A parashikon plani/analiza përfshirjen e ekspertëve të medias, shoqërisë civile, akademisë në zbatimin e këtyre akteve dhe përfaqësimit në përbërjen e strukturave përgjegjëse? Nëse po, cila është natyra e kësaj përfshirje dhe për cilat struktura behet fjalë?</li> <li>• A përfshihet/planifikohet një qasje e koordinuar në nivelin e rajonit të Ballkanit në raport me Aktin për Shërbimet Digjitale dhe Aktin e Tregut Digjital të Bashkimit Evropian? Nëse po, ju lutem jepni informacion mbi këtë plan.</li> </ul>				
12	26.02.2024	<p>Në kudër të zbatimit të projektit “WeLead: EU Scheme for Young Professionals in the Western Balkans”, projekti 4 vjeçar i mbështetur nga EU dhe zbatuar nga CEF, dhe hartimit të një policy paper, ju lutem më informoni:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sa titullarë ka pasur institucioni në</li> </ol>	06.03.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj</p> <p>Përgjigje nr. 1: 3 Titullarë Gent Cakaj 2019, Olta Xhaçka 2020, Igli Hasani 2023.</p> <p>Përgjigje nr. 2: Nr. Total i punonjësve: 169, Nr. i punonjësve që kanë dhënë dorëheqjen</p>	E plotë	Pa tarifë

		<p>periudhën 2019-2023 dhe në cilat vite saktësisht kanë ndodhur ndërrimet?</p> <p>2. Sa është numri i punonjësve të larguar nga institucioni për periudhën 2019-2023?</p> <p>3. Sa është raporti i vlerësimit të performancës të punonjësve të larguar në periudhën 2019-2023?</p> <p>4. Sa është numri i punonjësve që kanë pezulluar statusin dhe (nuk) janë rikthyer për periudhën 2019-2023?</p> <p>5. Nëse punonjësit nuk janë rikthyer në pozicionet e mëparshme në institucion, cilat janë arsyet?</p> <p>6. A keni program të dedikuar për punësimin e talentit në institucion?</p> <p>7. A i identifikon vetë institucioni talentet brenda organizatës? Nëse po, cilat janë kriteret që përdoren? Nëse jo, a është diskutuar ndonjëherë kjo çështje brenda institucionit?</p>		<p>2019: 4 2020: 2 2021: 0 2022: 0 2023: 0</p> <p>Nr. i punonjësve të larguar për shkak të ligjit 2019: 0 2020: 0 2021: 0 2022: 0 2023: 0</p> <p>Përgjigje nr. 3: Nr. i punonjësve që kanë dhënë dorëheqjen me vlerësimet si më poshtë: Shumë mirë: 0 Mirë: 0 Kënaqshëm: 0 Jo kënaqshëm: 0</p> <p>Nr. i punonjësve të larguar për shkak të ligjit me vlerësimet si më poshtë: Shumë mirë: 0 Mirë: 0 Kënaqshëm: 0 Jo kënaqshëm: 0</p>		
13	05.03.2024	<p>Kërkesë në lidhje me vendimin e Komitetit për të drejtat e njeriut me objekt pranimin e kërkesës për marrjen e masës së pezullimit.</p> <p>A i është komunikuar MEPJ</p>	06.03.2024	<p>Në përgjigje tuajës, ju bëjmë me dije si vijon: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është njoftuar për regjistrimin e çështjes së z. E.Q në Komitetin për të Drejtat e Njeriut. Zyra e Komisionerit të Lartë</p>	E plotë	Pa tarifë

		<p>një kopje e këtij vendimi?</p>		<p>për të Drejtat e Njeriut, përmes një note verbale të datës 17 janar 2024, ka përcjellë njoftimin se në datën 21 dhjetor 2023, në emër të z. E.Q, është bërë një komunikim në adresë të Komitetit për të Drejtat e Njeriut (CCPR) për shqyrtimin e rastit sipas protokollit opsional. Ky komunikim është regjistruar me numrin 4565/2024.</p> <p>Njoftimi i zyrë së Komisionerit të Lartë i është komunikuar Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nga ana e MEPJ.</p>		
14	06.03.2024	<p>Kërkesë për vënie në dispozicion të disa akteve dhe praktikave dokumentare.</p>	20.03.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Së pari, administruar gjenden dokumentet e kërkuara me përjashtim të tre kërkesave për arsyet e argumentuara më poshtë.</p> <p>Sa i takon pikës 9 të kërkesës për informacion, për këtë kërkim rezulton se MEPJ nuk ka përgatitur një urdhër të tillë.</p> <p>Sa i takon pikës 10 të kërkesës për informacion, referuar dispozitave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” informacioni i kërkuar i nënshtrohet mbrojtjes së të dhënave personale.</p> <p>Sa i takon pikës 13 dhe 14 të kërkesës për informacion, sqarojmë se në bazë të udhëzimit nr. 284/2015 “Për caktimin e zonave të sigurisë të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror, të NATO, të BE, të shteteve dhe</p>	E plotë	Pa tarifë

				<p>organizatave të tjera Ndërkombëtare në MEPJ dhe në Përfaqësi Diplomatike dhe Konsullore të RSH-së të akredituara jashtë vendit” ambientet e MEPJ janë klasifikuara në zona sigurie të ndryshme dhe për rrjedhojë administrimi i këtyre pamjeve është i kufizuar.</p> <p>Gjithashtu storage e regjistrimit të kamerave të sigurisë të vendosura në ambientet e brendshme të institucionit teknikisht mbajnë regjistrimin deri në dy javë. Për rrjedhojë ky kërkim është i pamundur t’ju vihet në dispozicion.</p>		
15	12.03.2024	<p>Kërkesë nga z. K. H. për vënie në dispozicion të dosjes së babait të tij, i cili ka qenë Ministër Fuqplotë i Republikës Popullore të Shqipërisë në Republikën e Italisë, në vitet 1949 – 1951.</p>	29.03.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, lidhur me dosjen personale të ish punonjësit në MEPJ për vitet 1949 – 1951, ju bëjmë me dije se në arkivin e MEPJ ndodhet vetëm dokumentacioni të cilin e përcjellim bashkëlidhur.</p>	E plotë	Pa tarifë
16	18.03.2024	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me këto pyetje:  Ministria ruse e Mbrojtjes pretendon se që prej fillimit të luftës me Ukrainën, 197 shqiptarë i janë bashkuar luftës. Pretendohet gjithashtu se 87 mercenarë shqiptarë janë vrarë në luftën në Ukrainë.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. A janë të sakta këto pretendime?</li> <li>2. A ka mercenarë shqiptarë në Ukrainë dhe nëse po, sa prej tyre kanë humbur jetën?</li> </ol>	29.03.2024	<p>Në lidhje me sa keni kërkuar ju bëjmë me dije se MEPJ nuk ka patur dhe nuk ka asnjë të dhënë zyrtare për të vrarë me nënshitetësi shqiptarë, të përfshirë në konfliktin e armatosur Rusi – Ukrainë.</p>	E plotë	Pa tarifë

17	29.03.2024	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me delegimin e kompetencave ligjore të Ministrit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.</p> <p>A keni bërë zëvendësimin/kalimin e këtyre kompetencave ligjore te një vartësi juaj?</p> <p>Nëse po, ju lutem të na vihet në dispozicion urdhri në bazë të së cilit është bërë kalimi i këtyre kompetencave.</p>	09.04.2024	Në tërësi të leximit të kërkesës vihet re se përgjigja e kërkuar referohet tek nenet 14 dhe 15 të Ligjit nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm”.	E plotë	Pa tarifë
18	08.04.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion një kopje të Memorandumit të Mirëkuptimit Kundër Manipulimit të Informacionit të Shtetit të Huaj (dezinformimit) me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.	11.04.2024	Deleguar Kryeministrisë	E plotë	Pa tarifë
19	09.04.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion një kopje të Memorandumit të Bashkëpunimit Shqipëri – SHBA për luftën kundër dezinformimit.	11.04.2024	Deleguar Kryeministrisë	E plotë	Pa tarifë
20	17.04.2024	Kërkesë për qasje në disa dokumente arkivore të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Konkretisht kopje të dosjes “Xhon Megou, problemi për caktimin si Konsull Nderi i Shqipërisë në Zvicër”.	24.04.2024	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, bashkëlidhur ju përcjellim materialin e kërkuar.	E plotë	Pa tarifë
21	18.04.2024	Në lidhje me një raport për të drejtat themelore në kufijtë e jashtëm tokësor dhe detar të BE-së, kërkohet plotësimi i disa pyetjeve nga struktura e MEPJ përgjegjëse për raportimin dhe	24.04.2024	Kërkesë e deleguar te <a href="mailto:policiaeshtetit@asp.gov.al">policiaeshtetit@asp.gov.al</a>	E plotë	Pa tarifë

		refuzimin e hyrjeve në kufijtë Shqiptar.				
22	18.04.2024	Në lidhje me votimin e rezolutës që dënon masakrën e Sebrenicës: 1 A mund të na thoni se çfarë qëndrimi do të mbajë Shqipëria, si do të votojë për këtë rezolutë? A ka pasur kërkesa zyrtare nga ana e Serbisë drejtuar Shqipërisë që të votojë kundër apo të abstenojë?	25.04.2024	<p>Në përgjigje Tuajës me nr. 23 regjistri, datë 18.04.2024, ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Shqipëria është pjesë e Grupit të Miqve për Srebrenicën në Kombet e Bashkuara, i cili ka përgatitur dhe ka qarkulluar anëtarësisë së OKB-së, draftin e rezolutës mbi shpalljen e 11 korrikut si "Dita Ndërkombëtare e Reflektimit dhe Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë".</p> <p>Grupi i Miqve për Srebrenicën është krijuar vitin e kaluar (2023) dhe ka në fokus përkujtimin e gjenocidit të ndërmarrë nga forcat serbe, ndaj popullsisë myslimane të B-H në vitin 1995. Aktualisht në këtë grup bëjnë pjesë 16 shtete, përfshirë edhe Shqipërinë. Grupi bashkë drejtohet nga Gjermania, Ruanda dhe B-H.</p> <p>Në këtë kuadër, Shqipëria (si pjesë e Grupit të Miqve) është e angazhuar në lobimin me grupe shtetesh për një mbështetje sa më të gjerë për këtë rezolutë. Ndërkohë, Serbia, Rusia dhe përfaqësuesit serbë të B - H po llojnë për bllokimin e saj.</p> <p>Qëndrimi ynë, krahas dënimit të mohimit të gjenocidit në Srebrenicës, dënon retorikën politike që nxit urrejtjen ndëretnike duke mohuar gjenocidin në</p>	E plotë	Pa tarifë

				<p>Srebrenicë dhe krimet e tjera të luftës të kryera në ish- Jugosllavi.</p> <p>Kujtojmë gjithashtu se Kuvendi i Shqipërisë ka njohur gjenocidin në Srebrenicë përmes një rezolute të miratuar në korrik 2022.</p>		
23	22.04.2024	<p>Kërkesë për vënie në dispozicion të relacioneve përfundimtare të VKM-ve të miratuara me propozim të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme:</p> <p><b>Nr. 93, datë 21.02.2024</b>          "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"</p> <p><b>Nr. 120 datë 6.3.2024,</b>          "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës"</p> <p><b>Nr. 121 datë 6.03.2024</b>          "Për një ndryshim dhe një shtesë në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe</p>	26.04.2024	Vënë në dispozicion përgjigja kërkuar.	E plotë	Pa tarifë

shfuqizimin e masave  
shtrënguese

ndërkombëtare, të  
ndryshuara", të  
ndryshuar"

**Nr. 122 datë 6.03.2024**

"Për një shtesë në  
vendimin nr. 173, datë  
18.3.2022, të Këshillit të  
Ministrave, "Për  
dhënien e mbrojtjes së  
përkohshme shtetasve  
ukrainas, personave pa  
shtetësi dhe personave  
që kanë fituar mbrojtje  
ndërkombëtare në  
Ukrainë, me  
vendqëndrim të  
përkohshëm ose të  
përhershëm në Ukrainë,  
si dhe për krijimin e  
task-forcës për  
menaxhimin e fluksit të  
kërkuesve të mbrojtjes  
ndërkombëtare të  
ndryshuar

**Nr. 123 datë 6.03.2024**

"Për një shtesë në  
vendimin nr. 501, datë  
25.8.2021, të Këshillit të  
Ministrave, "Për  
dhënien e mbrojtjes së  
përkohshme shtetasve  
afganë dhe personave pa  
shtetësi, me  
vendqëndrim të  
përkohshëm ose të  
përhershëm në  
Republikën Islamike të  
Afganistanit, dhe për  
krijimin e task-forcës  
për menaxhimin e  
fluksit të kërkuesve të  
mbrojtjes  
ndërkombëtare", të  
ndryshuar"

**Nr. 124 datë 6.03.2024**

"Për një ndryshim në  
vendimin nr. 169, datë  
18.3.2022, të Këshillit të  
Ministrave, "Për



përcaktimin e afatit të hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të Ukrainës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"

**Nr. 134 datë 6.03.2024**

"Për një ndryshim në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"

**Nr. 147 datë 13.03.2024**

"Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"

**Nr. 160 datë 20.03.2024**

"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të

ndryshuar"  
**Nr. 168 datë 20.03.2024** "Për një ndryshim në vendimin nr. 858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"

**Nr. 183 datë 27.03.2024** "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar"

**Nr. 219 datë 09.04.2024** "Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për përjashtimin e ndërsjellë të kërkesës për vizë për mbajtësit e pasaportave të zakonshme"

**Nr. 220 datë 09.04.2024** "Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së

		Shqipërisë dhe Kabinetit të Ministrave të Ukrainës, për punësimin fitimprurës të anëtarëve të familjes së anëtarëve të familjes së anëtarëve të misioneve diplomatike, ose posteve konsullore"				
24	22.04.2024	Kërkesë për informacion për vitet e punës së znj. A.Sh. në Ambasadën e Shqipërisë në Rumani, nga shtatori i vitit 2000 deri në korrik të vitit 2006. Ka shërbyer si sanitare e ambasadës.	07.05.2024	Në përgjigje të kërkesës lidhur me punësimin e znj. A.Sh. sipas dokumenteve arkivore të përfaqësisë, zonja ka filluar punën e sanitares së Ambasadës në datë 4 shtator 2000 deri në 31 korrik 2006.	E plotë	Pa tarifë
25	21.05.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me kandidaturën e z. M.T. oficer detar në Forcat Detare të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për të qenë pjesë e trajnimit "Strategic Fellowship Programme" për çështjet e oqeaneve dhe të drejtën e detit. Kandidatura është përcjelle në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, njoftim ky i ardhur, në muajin shkurt, nga zyra e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes. Kërkoj informacion mbi statusin e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve, nëse ende kam mundësi për të ndjekur kursin apo jo dhe procesin që duhet të ndjek në rast se përzgjidhem për të vazhduar këtë trajnim.	28.05.2024	Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion ju bëjmë me dije si vijon: Në përgjigje të kërkesës Tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se:  Me shkresën me nr. 19012 prot., datë 26.12.2023 "Përcillet njoftim për hapjen e aplikimeve për bursë për Startegic Fellowship Programme nga Divizioni për Çështjet e Oqeanit dhe të Drejtën e Detit i Kombeve të Bashkuara", është bërë informimi i Ministrisë së Mbrojtjes (për djepin: Komanda e Forcës Detare dhe Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake) mbi hapjen e aplikimeve për programin 4-mujor Strategic Fellowship. Në shkresë është sqaruar se aplikimi duhet të përcillet drejtpërdrejtë nga aplikanti në postën elektronike të Divizionit për Çështjet e Oqeanit dhe të Drejtën e Detit (doalos@un.org) si dhe	E plotë	Pa tarifë

				<p>është përcjellë linku i nevojshëm për kryerjen e aplikimit onl-line. Afati për aplikim ka qenë 16 shkurt 2024.</p> <p>Më 9 janar 2024, pas kërkesës telefonike të specialistes së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, znj. J. B., është përcjellë informacion shtesë lidhur me Rregullat e bursës, duke përfshirë akomodimin, mbulimin e shpenzimeve dhe marrjen e pagesës, marrjen e vizës, çështjet e sigurimit shëndetësor etj në format elektronik.</p> <p>Ministria e Mbrojtjes me shkresën me nr. 599/1prot., datë 31.01.2024 "Kthim përgjigje ftesës për ndjekjen e Strategic Fellowship Programme pranë Kombeve të Bashkuara" informon se përfaqësuesi i përzgjedhur është L. M. T.</p> <p>Sqarojmë se Drejtoria/MEPJ e ka bërë të qartë se aplikimi duhet të bëhet nga aplikanti drejtpërdrejtë te Divizioni dhe nëpërmjet linkut për aplikim. Po ashtu, theksojmë se MEPJ nuk është strukturë për vlerësimin e kandidatëve të mundshëm, të cilët mund të aplikojnë në këtë program burse. Funkzioni ynë është përcjellja e ftesës për aplikim.</p>		
26	21.05.2024	Kërkesë të informohemi me shkrim në rast se autorizimi (prokura) datë 01.08.2003 hartuar	28.05.2024	Në përgjigje të kërkesës Tuaj, ju bëjmë me dije si vijon. Në bazë të kuadrit ligjor	E plotë	Pa tarifë

në Republikën e Venezuelës ishte e vlefshme apo përdorej asokohe në Republikën e Shqipërisë pa vulën apostile, e konkretisht para noterit.

në vitin 2003 midis shtetit të Venezuelës dhe Shqipërisë procedura për legalizimin e dokumentit në fuqi ka qenë legalizim i thjeshtë.

Dokumenti i lëshuar nga një noter në Venezuelë, duhej të dërgohej për legalizim të thjeshtë pranë autoritetit kompetent si vijon:

Ministerio del Poder Popular para Relaciones Exteriores, Oficina de Relaciones Consulares (Ministry of People's Power of Foreign Affairs Office of Consular Affairs), Avenida Urdaneta, Esquina Carmelitas a Puente Llaguno, Torre Anexo a Torre MRE Piso 1, Caracas, 1010, Republica Bolivariana de Venezuela.

Pasi akti të jetë vulosur nga ky institucion, dokumenti do të duhet të dërgohej pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë që e mbulon, për verifikim dhe vulë nga Konsulli i Ambasadës ose bazuar në VKM 134 datë 07.03.2003, duke qenë se ne nuk kemi përfaqësim në Venezuelë dhe Venezuela nuk ka pasur përfaqësi në Shqipëri, dokumenti mund të ishte dërguar pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (asokohe Ministria e Punëve të Jashtme) për legalizim të thjeshtë.

Pas marrjes së vulave si më sipër, dokumenti i lëshuar nga Venezuela në vitin 2003 do të ishte i vlefshëm në Republikën e Shqipërisë. Nëse vulat

				përkatëse mungojnë, atëherë dokumenti nuk është i vlefshëm për në Shqipëri.		
27	20.05.2024	<p>Kërkesë për vënie në dispozicion të informacioneve të mëposhtme:</p> <p>1. Buxheti në dispozicion: Cili është buxheti i vënë në dispozicion nga shteti shqiptar, përfshirë Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencinë Kombëtare të Diasporës, për mbështetjen e komuniteteve shqiptare në rajonin e Ballkanit Perëndimor? (shoqëruar me zërat përkatës).</p> <p>2. Roli i MEPJ: Cili është roli që luan MEPJ në mbrojtjen e interesave të komunitetit shqiptar jashtë kufijve të Shqipërisë? Cilët janë mekanizmat dhe politikat konkrete të zbatuara nga MEPJ për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e këtij komuniteti?</p> <p>3. Baza e të dhënave: A ka aktualisht shteti shqiptar ose MEPJ, një bazë të dhënash të përditësuar me të dhëna mbi numrin dhe nevojat e komuniteteve shqiptare jashtë vendit? Nëse po, cili është statusi i kësaj baze të dhënash dhe si përdoret ajo për të adresuar kërkesat e komuniteteve?</p> <p>4. Sa është numri i shqiptarëve të</p>	04.06.2024	<p>Në përgjigje Tuajës ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>1. Agjencia Kombëtare e Diasporës, nëpërmjet veprimtarive të saj, shërben për krijimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve të shtetit shqiptar me diasporën në të gjithë botën, duke mos u kufizuar në një rajon të caktuar. Buxheti vjetor përcaktohet sipas prioriteteve, numrit të përqendrimit të shqiptarëve në vendet pritëse, nevojat e tyre apo referuar ndjeshmërisë dhe karakteristikave të veçanta të komuniteteve.</p> <p>Edhe në buxhetin e vitit 2024, të gjitha bashkëpunimet me diasporën shqiptare janë të përfshira në zërin buxhetor "Aktivitete dhe takime në komunitetet shqiptare në Diasporë" dhe jo të ndara në mënyrë specifike për komunitetet shqiptare të Ballkanit Perëndimor.</p> <p>Ju bëjmë me dije se referuar Ligjit 97/2023, "Për Buxhetin e vitit 2024", MEPJ alokon fonde buxhetore për funksionimin e misioneve diplomatike dhe konsullore të RSh – së në shtete e huaja.</p> <p>Në fondet buxhetore të akorduar për aktivitete operacionale të tyre përfshihen gjithashtu fondet për organizmin e aktivitete të përbashkëta në mbështetje të</p>	E plotë	Pa tarifë

regjistruar sipas secilës nga ambasadat e shtetit shqiptar? (informacioni i shprehur në numër dhe i klasifikuar sipas secilës ambasadë më vete)

5. Sa është numri i rasteve të raportuara në secilën nga ambasadat e shtetit Shqiptar në botë në vitin 2022 dhe 2023? (informacioni i shprehur në numër dhe i klasifikuar sipas secilës ambasadë më vete)

6. Cilat janë problematikat më të shpeshta për të cilat emigrantët shqiptarë i drejtohen ambasadave?

7. Objektivat e MEPJ: Cilat janë objektivat specifike të MEPJ-së për mbrojtjen dhe mbështetjen e komunitetit shqiptar në rajonin e Ballkanit Perëndimor për vitin 2023 – 2024?

komunitetit shqiptar (në rast se ka aktivitete të tilla).

2. Marrëdhënia me Diasporën është riorganizuar, është evidente që diaspora është prioritet për Qeverinë Shqiptare. Tashmë ne kemi një marrëdhënie të institucionalizuar, janë ngritur institucione të dedikuara tërësisht diasporës. Këto institucione kanë një qëllim të vetëm, ngritjen e kësaj marrëdhënie në një nivel tjetër dhe përfshirjen e përfaqësuesve të saj në politikën vendimmarrëse për funksionimin e kësaj marrëdhënie.

Lidhja e fortë me diasporën u shënuar me realizimin e 3 Samiteve të Diasporës. Samiti I Diasporës shërbeu si katalizator energjie për të vënë në lëvizje këtë makineri. Emigrantët shqiptarë kanë më shumë akses në ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale. Samiti II Diasporës mundësoi një hapësirë diskutimi për çështje të ndryshme të politikë bërjes së shtetit shqiptar, përfshirë qasjen e re të bashkëpunimit me Diasporën dhe njëkohësisht këndvështrimin e Diasporës mbi impaktin e këtyre politikave, duke evidentuar sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë këtij bashkëpunimi. Samiti i III Diasporës mundësoi rigjallërimin e formave konkrete të

bashkëpunimit mes vendit amë dhe Diasporës,

Puna intensive e qeverisë shqiptare përmes hartimit të politikës shtetërore është konkretizuar me Strategjinë Kombëtare për diasporën 2021-25. Strategjia Kombëtare për diasporën 2021-25 ka për qëllim kryesor thellim të bashkëpunimit kulturor, të biznesit, të arsimit, ku më e rëndësishmja është nxitja e hapjes së shkollave shqipe në diasporë, mbështetja e arsimitarëve, etj. Qëllimi është që shtetasit të cilët punojnë dhe jetojnë jashtë atdheut ta bëjnë diasporën pjesë të frymës ekonomike, kulturore, arsimore.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë është e angazhuar për të pestin vit radhazi, me përgjegjësi, në procesin e identifikimit të nevojave dhe kërkesave për tekste nga përfaqësitë diplomatike e konsullore për vitin shkollor 2024-2025.

Aktivizimi i ministrive përgjegjëse të arsimit, diasporës dhe atyre të jashtme nga Shqipëria dhe Kosova, dhe miratimi për herë të parë i tekstit të përbashkët, jo vetëm ka ndikuar pozitivisht në frekuentimin e klasave dhe cilësinë e mësimin, por edhe ka krijuar ndjeshmërinë tek prindërit dhe fëmijët e diasporës se institucionet e vendeve amë janë



thellësisht të angazhuar për ngritjen e cilësisë së mësimi të gjuhës, historisë dhe kulturës kombëtare.

MEPJ mbetet e përkushtuar për të zhvilluar një dialog të vazhdueshëm në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve, në respekt të standardeve dhe detyrimeve ndërkombëtare, duke vlerësuar peshën, rolin dhe kontributin e tyre në vendet ku ata jetojnë.

Nënshkrimi i Marrëveshjeve me Kosovën dhe Maqedoninë për bashkëpunim në fushën e diasporës.

Gjithashtu, shërbimi sa më i mirë ndaj qytetarëve tanë jashtë vendit ka qenë kryefjala e punës së Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme. Shërbimet Konsullore Online (SHKO) e cila ka pasur si qëllim afrimin e qytetarëve shqiptarë më afër shërbimeve, si dhe digjitalizimin konsullor duke standardizuar formatet dhe dokumentet, ka rritur transparencën dhe cilësinë e shërbimeve dhe ka ulur ndjeshëm tarifat, kohën dhe procedurat për qytetarët shqiptarë kudo që ata ndodhën.

Në përfaqësitë tona diplomatike dhe konsullore në Itali dhe Greqi janë emëruar punonjës që trajtojnë posaçërisht problematikat e diasporës shqiptare në

këto shtete.

3. MEPJ disponon një bazë të dhënash të cilat identifikojnë diasporën shqiptare si dhe një katalog të Profesionistëve shqiptarë në Diasporë që punojnë dhe jetojnë jashtë.

4. Në lidhje me këtë pyetje, lutemi të specifikoni kategorinë/target grupin për të cilën kërkoni informacion.

5. Në lidhje me këtë pyetje, lutemi të specifikoni kategorinë për të cilën kërkoni informacion.

6. Rastet më të shpeshta janë ato të regjistrimit të akteve juridike të lindjes, martesës dhe vdekjes. Pajisjes me leje kalimi në rastet e skadimit të dokumenteve të udhëtimit, humbjes apo dëmtimit të tyre.

7. Veprimtaria e MEPJ me shqiptarët në rajon bazohet, ndër të tjera, mbi Kushtetutën e RSH-së, ku kujdesia për ta fiksohet si një normë kushtetuese. Si i tillë, realizimi i kësaj veprimtarie derivon si një detyrim sa ligjor, po aq edhe moralo-politik. MEPJ pasqyron dhe ekzekuton me instrumentet e saj diplomatiko – financiarë, pikërisht, këtë përkujdesje, që nuk bie në kundërshtim as me ligjin dhe dokumentet ndërkombëtare në përgjithësi, por as me legjislacionin e

brendshëm të vendeve të rajonit, ku shtrihet popullsia autoktone shqiptare. Për korrektesën e Tiranës në këtë drejtim flet edhe fakti që nga kryeqytetet e vendeve të rajonit nuk janë adresuar ankesa, apo pakënaqësi zyrtare.

Në punën dhe objektivat e saj MEPJ, gjatë periudhës në fjalë e në vijim, nuk e ka trajtuar statusin e shqiptarëve në MZ, Serbi e MV, si një konstante me terma përgjithësues. Sigurisht që ekziston emëruesi i përbashkët i këtij statusi, por puna në terren dikton gjithnjë marrjen parasysh të veçorive dhe objektivave të detajuar.

Psh. në rastin e shqetësimeve të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, diplomacia jonë tregohet sistematikisht aktive në organizatat ndërkombëtare OSBE, KIE etj, për të sensibilizuar problemet e tyre, në mos për të stimuluar presionin ndërkombëtar mbi Beogradin për t'i dhënë zgjidhje atyre.

Nga ana tjetër, në MZ, çelja për herë të parë e Konsullatës së Përgjithshme të RSH-së, në Ulqin-Tivar (Bar), që është në fazën përfundimtare të materializimit, demonstroi për një interes të shtuar dhe vëmendje të përqendruar të Tiranës për shqiptaret e MZ-së. Edhe çelja e afërt e ambasadës tonë në

				<p>BiH, nuk e përjashton aspak këtë element përkujdesës ndaj komunitetit shqiptar atje.</p> <p>Për shqiptarët e MV-së puna e MEPJ-së shtrihet në stimulimin e vetë ndërgjegjësimit dhe të forcimit të identitetit të tyre si element shtetformues në këtë shtet. Sigurisht, kjo veprimtari merr parasysh gjithnjë mosndërhyrjen në punët e brendshme të atij vendi.</p> <p>MEPJ-ja, vitet e fundit, sot në veprim e sipër, por edhe në planifikim afatgjatë koordinon me terma konkretë financiarë ndihmën e qeverisë shqiptare me fonde të posaçme për Këshillat Kombëtare Shqiptare (Serbi, MZ). Gjithashtu, harmonizon, inkurajon, organizon ndihmën e bashkive, universiteteve, dikastereve të ndryshme për shqiptarët në rajon në fushën arsimore, kulturore, mjekësore, etj.</p>		
28	22.05.2024	Kërkesë e deleguar nga Adisa. Aplikim për shtetësinë Shqiptare të znj. A. N.	24.05.2024	<p>Pas vlerësimit të kërkesës për informacion të deleguar në MEPJ, sqarojmë si vijon: Kërkesa duhet t'i përcillet MB si institucion kompetent, i cili ka edhe një drejtor të dedikuar për këto procedura. Sqarojmë se për t'i ardhur në ndihmë shtetases aplikimi për fitim shtetësie kryhet nëpërmjet portalit qeveritar e – albania në të cilin institucioni ynë nuk është i përfshirë .</p>	E plotë	Pa tarifë

29	03.06.2024	<p>Pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, në datën 30 maj, qytetari z. R.M. ka kërkuar tekstin në gjuhën shqipe të Konventës Ndërkombëtare të Eurocontrol-it.</p> <p>Në vijim të kërkesës së mësipërme, në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, lutemi brenda mundësive nga ana juaj informacionin e kërkuar. kjo kërkesë ju përcillet ju, për shkak se Autoriteti i Aviacionit Civil nuk e disponon në gjuhën shqipe Konventën e kërkuar.</p> <p>Republika e Shqipërisë ka aderuar në Konventë me Ligjin Nr. 8821, datë 15.10.2021 “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPERISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE TË EUROCONTROL – IT”</p>	13.06.2024	<p>Në përgjigje Tuajës, sa i takon tekstin në gjuhën shqipe të Konventës Ndërkombëtare të Eurocontrol – it, ju bëjmë me dije se pas kontrollit nga Drejtoria e Arkivit Historik ku depozitohen marrëveshjet dy dhe shumë palëshe, nuk gjendet teksti i Konventës Ndërkombëtare të EUROCONTROL – it.</p>	E plotë	Pa tarifë
30	03.06.2024	<p>Për sa i përket përditësimit të akteve për ndryshimet që ka pësuar akti origjinal, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Më datë 6.12.2023, me Vendim Nr. 698, Këshilli i Ministrave, ka dalë me vendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar. (bashkëlidhur vendimi)</p>	20.06.2024	Kërkesë deleguar Kryeministritë.	E plotë	Pa tarifë

Në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi është vendosur ndryshimi ose shtimi në listën bashkëlidhur vendimit e cila është në version të skanuar.  
Specifikisht:

1. Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtore me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohen katër individë të renditur në shkronjën "a", sipas shtesave që i bashkëlidhen këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtare, bashkëpunëtore apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida. .

2. Në listën e shkronjës "D", te titulluar "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida", shtohet kompania e renditur në shkronjën "a", sipas shtesave që i bashkëlidhen këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida.

Meqenëse në listë nuk mund të ndërhyhet për shkak të versionit skanim, lutem paraqitjen e listës së përditësuar në mënyre që të botohet vendimi nr. 718 datë 29.10.2004 i

		përditësuar.				
31	03.06.2024	<p>QBZ, në zbatim të ligjit nr. 78/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e QBZ-së", gjatë procesit të përditësimit të akteve që kanë pësuar ndryshime, konstatojmë se Vkm nr.1128, dt. 30.12.2020 "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara" i botuar në FZ. nr. 6, dt.14.1.2024 është teknikisht e pa përditësueshme nga ne, për shkak të tekstit të aktit, i cili është i skanuar dhe nuk mund të ndërhyjë në brendësi të përmbajtjes.</p> <p>Në kuadër të Transparencës ndaj publikut dhe në zbatim të ligjit, lutemi të na dërgoni versionin final të tij, në Word, të përditësuar, me qëllim publikimin e Vkm-së 1128/2020 në web-in e institucionit, në versionin përfundimtar.</p> <p>Ose, nëse është e mundur, mund të na dërgoni, versionin e përditësuar në link, me qëllim lidhjen e aktit në web-in e QBZ-së me linkun tuaj.</p>	20.06.2024	Kërkesë deleguar Kryeministritë.	E plotë	Pa tarifë
32	07.06.2024	Cili është qëllimi i kërkesës drejtuar Prokurorisë së Tiranës,	13.06.2024	Në përgjigje Tuajës ju bëjmë me dije si vijon: Ministria për Evropën	E plotë	Pa tarifë

		<p>lidhur me përditësimin e hetimeve të Prokurorisë së Ukrainës në kuadër të ngjarjes së 6 marsit 2022, ku godina e Konsullatës së Nderit të RSH – së në Kharkiv, u shkatërrua?</p> <p>Çfarë masash do të marrë Shqipëria ndaj Rusisë nëse hetimet e faktojnë sulmin ndaj konsullatës?</p>		<p>dhe Punët e Jashtme ka dënuar me forcë sulmin e forcave të armatosura ruse të datës 6 mars, 2022 ndaj qytetit të Ukrainës, Kharkiv, ku si pasojë është goditur dhe shkatërruar Konsullata e Nderit e Shqipërisë për këtë rajon. Interesimi i MEPJ lidhet me faktin se ambientet e Konsullatës së Nderit të Republikës së Shqipërisë në Kharkiv, si institucion konsullor, kanë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me Republikën e Shqipërisë, në përputhje me normat ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore ndërmjet shteteve. Shprehje e ndjekjes me ecurinë e këtij rasti është edhe letra për Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, me kërkesën për bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm të Ukrainës, për tu informuar mbi ecurinë e hetimeve lidhur me rastin në fjalë. Nga informacioni që ka MEPJ, deri tani, rezulton se hetimet po vazhdojnë. Në përfundim të procedurave dhe në varësi të përfundimeve të dala, MEPJ do ndërmarrë hapa të tjerë, në përputhje me praktikat dhe dokumentet ndërkombëtare që parashikojnë raste të tilla.</p>		
33	17.06.2024	<p>Kërkesë për të marrë informacion dhe konfirmim zyrtar në lidhje me statusin e z. D.L. si konsull nderi i Shqipërisë në Lyon</p>	18.06.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj ju informojmë se z. D.L. është emëruar Konsull Nderi i RSH në Lyon të Francës nga Ministri i Punëve të Jashtme më 25 Prill 2007</p>	E plotë	Pa tarifë



		<p>(Francë). Aktualisht qarkullojnë informacione që pretendojnë se këtë pozicion e mban ende z. D.L. por në listat online në faqen tuaj të internetit, ai nuk figuron si një nga konsujt e nderit të Shqipërisë në Francë.</p> <p>Ju lutem të konfirmoni me shkrim nëse z. D.L. është apo jo konsull nderi i Shqipërisë në Lyon.</p>		<p>për një afat 4 vjeçar dhe më pas nuk është kërkuar më të rinovohet.</p>		
34	26.06.2024	<p>Kërkesë për vënie në dispozicion të Konventës Ndërkombëtare të EUROCONTROL për Bashkëpunimin për Sigurinë e Lundrimit Ajror, të amenduar nga protokollin shtesë, i nënshkruar në Bruksel më 6 korrik 1970, nga protokollin i 21 nëntorit të vitit 1978, dhe nga protokollin i nënshkruar në Bruksel më 12 shkurt 1981, dhe Marrëveshja Shumëpalëshe për Tarifat e Korridoreve Ajrore të 12 shkurtit të 1981.</p>	07.03.2024	<p>Është vënë në dispozicion përgjigjia/materiali kërkuesit.</p>	E plotë	Pa tarifë
35	01.07.2024	<p>Kërkesë për informacion, referuar 5 viteve të fundit, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Marrëveshje financiare me donatorë të huaj ku Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. ose institucionet në varësi të saj, janë përfituese fondesh në formë granti.</li> <li>Marrëveshjet financiare ku Ministria për Evropën dhe Punët e</li> </ol>	09.07.2024	<p>Në përgjigje Tuajës ju bëjmë me dije si vijon: MEPJ në 5 (pesë) vitet e fundit nuk ka qenë përfituese fondesh me donatorë 2 ose shumë palësh me fokus sektorin e arsimit.</p>	E plotë	Pa tarifë

		<p>Jashtme, është përfituese për hua zhvillimore për projekte në sektorët e kompetencës.</p> <p>3. Projektet, me financim të huaj, ku Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ose institucionet në varësi të saj, janë partner ose lead partner.</p>				
36	03.07.2024	<p>Kërkesë e deleguar nga ADISA mbi kërkesën për informacion të znj. D.Gj. në lidhje me procedurën që duhet të ndjekë për t'u pajisur me vizë hyrëse në Shqipëri bashkëshorti egjiptian.</p>	17.07.2024	<p>Në përgjigje tuajës ju bëjmë me dije si vijon: Aplikimi për çdo tip vize kryhet online në linkun <a href="https://e-visa.al/">https://e-visa.al/</a>. Në linkun e përcjellë mund të aplikohet për vizë të tipit D/bashkim familjar meqenëse konfirmon që është e martuar dhe besojmë që e ka të regjistruar martesën në RKGJC.</p>	E plotë	Pa tarifë
37	06.07.2024	<p>Kërkesë për informacion:</p> <p>1. Në qasjen politike dhe ekonomike, si vlerësohen investimet kineze në Shqipëri? A konsiderohen ato të mirëpritura?</p> <p>2. Në qasjen politike dhe ekonomike, si vlerësohen investimet ruse në Shqipëri? A konsiderohen ato të mirëpritura?</p> <p>3. A ka ndonjë iniciativë/ përpjekje nga Qeveria Shqiptare për të thithur më shumë investime të huaja nga Kina?</p> <p>4. A ka ndonjë iniciativë/ përpjekje nga Qeveria Shqiptare për të thithur më shumë investime të huaja nga Rusia?</p>	19.07.2024	<p>Për sa keni kërkuar, sa i takon fushës së përgjegjësisë së MEPJ, ju informojmë se: Shqipëria ofron një kuadër ligjor mjaft miqësor sa i takon investimeve të huaja. Ligji “Për Investimet e Huaja” mbështetet në parimet e barazisë, mos diskriminimit dhe mbrojtjes së investitorëve. Ligji nr. 7764 dt. 02.11.1993 “Për Investimet e Huaja”. Ligji nr. 10 316, datë 16.09.2010 “Për disa shtesa në ligjin nr. 7764 datë 02.11.1993 Për Investimet e Huaja”. Ligji “Për Investimet e Huaja” është hartuar për të krijuar një klimë të favorshme për investimet. Ligji ofron garanci për të gjithë të huajt (persona fizik ose juridik) të gatshëm për të investuar në Shqipëri.</p>	E plotë	Pa tarifë

38	10.07.2024	<p>Kërkesë për informacion, referuar 5 viteve të fundit, si më poshtë:</p> <p>1. Marrëveshje financiare me donatorë të huaj ku Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ose institucionet në varësi të saj, janë përfituese fondesh në formë granti.</p> <p>2. Marrëveshjet financiare ku Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, është përfituese për hua zhvillimore për projekte në sektorët e kompetencës.</p> <p>3. Projektet, me financim të huaj, ku Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ose institucionet në varësi të saj, janë partner ose lead partner.</p>	24.07.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Referuar VKM nr. 518, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”, funksionet e Drejtorisë së Bashkëpunimit Territorial dhe Drejtorisë së Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA – s në institucionin tonë i kanë kaluar Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) sipas pikës 4, Kreu 4, të VKM 642, datë 29.10.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”.</p>	E plotë	Pa tarifë
39	09.09.2024	<p>Kërkesë për informacion: A ka marrë Shqipëria konfirmim zyrtar nga NATO për organizimin e Samitit në vitin 2027? (NATO nuk e konfirmon ende Tiranën si vendndodhje të Samitit 2027)</p>	23.09.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Në përputhje me procedurat e NATO-s, dhe në konsultim me vendet e Aleancës Shqipëria ka paraqitur kërkesën formale për të pritur Samitin e NATO-s në Tiranë në vitin 2027. Në Samitin e radhës të NATO-s pritet formalizimi i vendimit për caktimin e Tiranës si vendi organizator i Samitit të NATO-s 2027. Kjo është hera e parë që ky samit do të mbahet në një nga vendet e Ballkanit Perëndimor.</p>	E plotë	Pa tarifë
40	20.09.2024	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me statusin e Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës</p>	26.09.2024	<p>Në përgjigje tuajës ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Referuar nenit 13 të “Marrëveshjes midis Qeverisë së Republikës</p>		

		<p>së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve, nëse është akoma në fuqi apo jo.</p>		<p>së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Nxitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve”, nënshkruar më 4 dhjetor 1997, marrëveshja rinovohet automatikisht për periudha 10 vjeçare nga data e hyrjes në fuqi. Çdo palë mund ta ndërpresë marrëveshjen duke njoftuar të paktën një vit para skadimit të periudhës aktuale. Investimet e realizuara përpara datës së ndërprerjes së marrëveshjes do të mbrohen dhe për një periudhë shtesë prej 10 vjetësh nga data e ndërprerjes. Marrëveshja vazhdon të jetë në fuqi për sa kohë që asnjëra nga palët nuk ka bërë një njoftim për ndërprerje të marrëveshjes. Vlen të theksohet se institucioni përgjegjës për dhënien e një informacioni më të saktë, nëse është bërë ndonjë njoftim për ndërprerje (pra kanë komunikuar drejtpërdrejtë) është Ministria e Financave.</p>		
41	08.10.2024	<p>Kërkesë për informacion: Sa persona nga Serbia dhe Maqedonia e Veriut kanë aplikuar në e – Albania për t’u punësuar në Shqipëri? Si është konkretisht procesi i aplikimit, cilat janë rrugët që duhet të ndjekë aplikanti?</p>	<p>Deleguar në datë 10.10.2024. Kthim përgjigje DPPSH në datë 22.10.2024.</p>	<p>Deleguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. <a href="mailto:policiaeshtetit@asp.gov.al">policiaeshtetit@asp.gov.al</a> Në përgjigje të kërkesës për informacion ju bëjmë me dije si vijon: Nga Serbia kanë aplikuar 632 shtetas, për leje qëndrimi unike “Punëmarrës” dhe unike “Vetëpunësim”, nga të cilat 406 janë miratuar, 10 janë në proces dhe 16 janë refuzuar.</p>	E plotë	Pa tarifë

				<p>Aktualisht në RSH rezultojnë 37 shtetas serbë, me leje qëndrimi aktive me motivin punëmarrës/vetëpunësim Nga Maqedonia e Veriut kanë aplikuar 1192 shtetas për leje qëndrimi unike “Punëmarrës” dhe unike “Vetëpunësim”, nga të cilat 1141 janë miratuar, 20 janë në proces dhe 31 janë refuzuar.</p> <p>Aktualisht në RSH rezultojnë 153 shtetas maqedonas me leje qëndrimi aktive me motivin punëmarrës/vetëpunësim</p>		
42	08.10.2024	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e emërimit të konsujve të huaj të nderit në Republikën e Shqipërisë, kriteret dhe procedurën që duhet të ndjekë një individ për t’u miratuar si konsull i huaj nderi në RSH, specifikisht për një shtet i cili nuk ka ambasadë apo konsull nderi aktualisht në Shqipëri.</p>	10.10.2024	<p>Në përgjigje Tuajës ju bëjmë me dije si vijon:</p> <p>Veprimtaria e Konsullit të Nderit të përcaktohet/rregullohet mbështetur në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dt. 10.04.1961, Konventën e Vjenës për marrëdhëniet konsullore dt. 24.04.1963, si edhe kuadrit ligjor në fuqi të vendeve përkatëse.</p> <p>Përzgjedhja e Konsullit të Nderit të huaj në RSH kryhet nga vendi dërgues të cilin përfaqëson kandidati (MEPJ nuk ka informacion se çfarë procedure ndjekin vendet e huaja në përzgjedhjen/paraqitjen e kandidatit për Konsull Nderi).</p> <p>Vendi dërgues kërkesën për emërimin e një konsulli nderi e përcjell me notë verbale nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në notë duhet të jenë të</p>	E plotë	Pa tarifë

				<p>specifikuar të dhënat mbi selinë dhe rrethin konsullor, adresën e plotë të kandidatit dhe oraret e funksionimit të tij për publikun.</p> <p>Sa me lart gjithashtu shoqërohet me CV, kopjen e pasaportës, si edhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore të kandidatit.</p> <p>Pas kryerjeve të formaliteteve për pranimin e kandidaturës dhe lejimin e aktivitetit, MEPJ lëshon ekzekuturën, e cila është e vlefshme për 4 vjet.</p>		
43	21.10.2024	<p>Kërkesë për vënie në dispozicion të relacioneve përfundimtare të VKM-ve të mëposhtme, të miratuara me propozim të Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme:</p> <p><b>1. Nr. 246 datë 17.4.2024:</b> “Për hapjen e misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Indisë”.</p> <p><b>2. Nr. 247 datë 17.4.2024:</b> “Për hapjen e misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kenias”.</p> <p><b>3. Nr. 248 datë 17.4.2024:</b> “Për hapjen e misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Indonezisë”.</p> <p><b>4. Nr. 269 datë 2.5.2024:</b> “Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të</p>	04.11.2024	<p>Në përgjigje Tuajës përcillen relacionet e kërkuara, përveç VKM – së nr. 329, relacionin përfundimtar të të cilës e disponon Ministria e Brendshme, që është iniciatori i aktit.</p>	E plotë	Pa tarifë

Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar".

**5. Nr. 270 datë 2.5.2024:** "Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr.420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"

**6. Nr. 284 datë 8.5.2024:** "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar".

**7. Nr. 290 datë 15.5.2024:** "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave

shtërnguese  
ndërkombëtare, të  
ndryshuara", të  
ndryshuar".

**8. Nr. 295 datë  
15.5.2024:** "Për  
pezullimin e pjesshëm të  
marrëveshjes, ndërmjet  
Këshillit të Ministrave të  
Republikës së  
Shqipërisë dhe Qeverisë  
së Republikës së  
Bjellorusisë, për heqjen  
reciproke të kërkesave  
për vizë".

**9. Nr. 308 datë  
22.5.2024:** "Për disa  
shtesa në vendimin nr.  
1128, datë 30.12.2020,  
të Këshillit të  
Ministrave, "Për  
zbatimin nga Republika  
e Shqipërisë të  
vendimeve të Këshillit  
të Bashkimit Evropian  
për vendosjen,  
ndryshimin dhe  
shfuqizimin e masave  
shtërnguese  
ndërkombëtare, të  
ndryshuara", të  
ndryshuar".

**10. Nr. 323 datë  
29.5.2024:** "Për disa  
shtesa në vendimin nr.  
1128, datë 30.12.2020,  
të Këshillit të  
Ministrave, "Për  
zbatimin nga Republika  
e Shqipërisë të  
vendimeve të Këshillit  
të Bashkimit Evropian  
për vendosjen,  
ndryshimin dhe  
shfuqizimin e masave  
shtërnguese  
ndërkombëtare, të  
ndryshuara", të  
ndryshuar".

**11. Nr. 329 datë  
29.5.2024:**  
"Për disa ndryshime dhe  
shtesa në vendimin nr.



858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

**12. Nr. 370 datë 5.6.2024:** "Për disa shtesa në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për

Listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar".

**13. Nr. 371 datë 5.6.2024:** "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar".

**14. Nr. 379 datë 12.6.2024:** "Për një ndryshim dhe një shtesë në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese

		<p>ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar".</p> <p><b>15. Nr. 397 datë 19.6.2024:</b> "Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar".</p>				
44	26.10.2024	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me toponimet e akteve të lindjeve të ardhura nga shteti grek edhe pse u referohemi listës së toponimeve.</p> <p>Këto kohë jemi duke u përballur me një problematikë të krijuar nga Drejtoria e Çështjeve Konsullore, Sektori i Legalizimit në lidhje me toponimin për të cilin akti është kthyer dy herë me shënime të ndryshme.</p> <p>Bashkëngjitur po ju nis dokumentet përkatëse për verifikim dhe zgjidhje të problemit.</p> <p>Ju lutemi të na mundësoni listën e re të toponimeve, që të mos hasim problematika të tilla, pasi regjistrimi gabim sjell pasoja si për qytetarin ashtu dhe për ne.</p>	31.10.2024	<p>Në përgjigje tuajës për informacion ju bëjmë me dije se kthimi i dokumentit është një detyrim i Ministrisë për të siguruar zbatimin e toponimeve sipas emërtimeve të depozituara nga shteti grek pranë OKB – së.</p> <p>Në kuadër të sa më sipër, është detyrim që toponimi për shtetasit që kanë lindur në Greqi të kenë toponimin e korigjuar.</p> <p>Sektori i Legalizimit, kur konstaton se toponimi nuk është i saktë, e kthen me fletën mbi arsyen përkatëse (gjatë shkrimit ka ndodhur gabim njerëzor). Në këtë kontekst, stafi i Sektorit orienton mbi toponimin, detyrues e ka gjendja Civile. Pas verifikimeve toponimi i saktë që Gjendja Civile duhet ta korigjojë është <b>IRAKLEION, GRC.</b></p> <p>Ngarkohet Zyra e Gjendjes Civile që të bëjë korigjimin e saktë, bazuar në VKM 555 të</p>	E plotë	Pa tarifë

				vitit 2014.		
45	28.10.2024	<p>Kërkesë për vënie në dispozicion dokumentet/informacionet zyrtare në lidhje me pajisjen me vizë turistike dhe pune për nënshtetasit e huaj.</p> <p>Më konkretisht:</p> <p>Sa është numri i personave të pajisur me vize-pune shqiptare për shtetasit me origjinë nga Egjipti, Siria, Palestina, Bangladeshi, Iraku dhe Jemeni nga periudha janar 2020 - 25 tetor 2024.</p> <p>1- Sa është numri i personave të pajisur me vizë - turistike shqiptare për shtetasit me origjinë nga Egjipti, Siria, Palestina, Bangladeshi, Iraku dhe Jemeni nga periudha janar 2020- 25 tetor 2024.</p>	07.11.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës Tuaj, bashkëlidhur ju përcjellim informacionin e kërkuar;</p> <p>1- Sa është numri i personave të pajisur me vizë-pune shqiptare për shtetasit me origjinë nga Egjipti, Siria, Palestina, Bangladeshi, Iraku dhe Jemeni nga periudha janar 2020 - 25 tetor 2024.</p> <p>Për periudhën e mësipërme Misionet Diplomatike dhe Postet Konsullore të RSH-së kanë lëshuar respektivisht, për shtetasit:</p> <p>Bengal - 1,688 viza punësimi</p> <p>Egjiptian - 1,047 viza punësimi</p> <p>Sirian - 438 viza punësimi</p> <p>Palestinezë asnjë vize punësimi</p> <p>Irakenë - 1 vizë punësimi</p> <p>Jemenas - 4 viza punësimi</p> <p>2- 1- Sa është numri i personave të pajisur me vizë-turistike shqiptare për shtetasit me origjinë nga Egjipti, Siria, Palestina, Bangladeshi, Iraku dhe Jemeni nga periudha janar 2020- 25 tetor 2024.</p> <p>Për periudhën e mësipërme Misionet Diplomatike dhe Postet Konsullore të RSH-së</p>	E plotë	Pa tarifë

				<p>kanë lëshuar respektivisht, për shtetasit</p> <p>Egjiptian - 327 viza turistike (Shtetasit egjiptianë bazuar në VKM nr. 214, datë 25.03.2021 kanë qenë pjesë së sezonit turistik pa vizë për periudhën 1 prill deri me 31 dhjetor 2021)</p> <p>Sirian - 156 viza turistike</p> <p>Palestineze - 9 viza turistike</p> <p>Bengal- 6 viza turistike</p> <p>Irakenë-19 viza turistike</p> <p>Jemenas- 3 viza turistike</p>		
46	29.10.2024	<p>Kërkesë për informacion lidhur me angazhimet dhe aktet e ndërmarra nga pala shqiptare për mundësimin e votës së shtetasve bullgare në Shqipëri gjatë votimit të ditëve të fundit në disa bashki. Sipas të dhënave tona monitoruese, votimi u bë në mjedise shkollore dhe publike, ndaj është e rëndësishme për ne të njoftojmë përgjegjësinë zyrtare të palës shqiptare në këtë rast, nëse ka marrëveshje reciproke dhe detyrimet ligjore/administrative dhe penale e palës shqiptare në këtë proces.</p> <p>Informacioni ka vlerë për ne në kuadër të monitorimit që po i bëjmë procesit të votimit të diasporës shqiptare në botë dhe</p>	07.11.2024	<p>Në përgjigje Tuajës për informacion, ju bëjmë me dije si vijon: Pala bullgare ka informuar zyrtarisht sipas praktikës diplomatike mbi organizimin e procesit zgjedhor për shtetasit bullgarë që dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e votës në Shqipëri, duke njoftuar për adresat e qendrave të votimit në qytetet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Korçë</li> <li>• Elbasan</li> <li>• Kukës</li> <li>• Durrës</li> </ul>	E plotë	Pa tarifë

